

## **PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall**

### **PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

#### **OBJEKTI I PROCEDURËS:**

**”Blerje MATERIALE PER NGROHJE PELET 2024”**

#### **KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**

**44115220-7**

#### **VLERA E FONDIT LIMIT:**

**1.454.640** *(një milion e katërqind e pesëdhjetë e katër mijë e gjashtëqind e dyzet)* lekë pa tvsh

Vlera e fondit limit është përlogaritur bazuar në Ligjin nr.162/2020 “Për prokurimin publik”,Kreu VI “rregulla të përgjithshme dhe përgatitja e procesit të prokurimit”,neni 34 “Përlogaritja e vlerës së parashikuar të prokurimit”,Vendimit nr.285 date 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 12 “Metoda të zbatueshme në përlogaritjen e vlerës së kontratës”.Komisioni i përlogaritjes se fondit limit i ngritur me Urdher Titullari nr.409 prot date 13.08.2024 bazuar ne Vendimin nr.285 date 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ,i ndryshuar,Nenin 76”Menyrat e përlogaritjes se vleres se prokurimit” pika 1 c ,cmimet e kontratave te meparshmete realizuara nga autoritetit kontraktor ose autoritete te tjera, ka llogaritur fondin limit per proceduren.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, neni 2, pika 2/c dhe neni 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,autoriteti/enti kontraktor Bashkia Maliq ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

#### **I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

*a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

*b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës3;*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, neni 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

## **2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

### **2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):**

Sipas kriterëve të përgjithshme të kualifikimit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

### **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

2.2.1. Kopje të deklaratave për xhiron vjetore të viteve 2021,2022,2023 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 30% e vlerës së fondit limit të kontratës që prokurohet.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

*Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin 9920 datë 19.05.2008 ,për "Procedurës Tatimore "neni 64 Deklarata Tatimore.*

2.2.2 Kopje të vërtetuar të bilancit për vitet 2021,2022,2023 të paraqitur dhe konfirmuar pranë autoriteteve përkatëse me nënshkrim dhe vulë si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar në përputhje me ligjin nr. 10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, Kreu V, neni 41, pika c "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm:

- i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh;
- ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh;
- iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël."

**Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme ,nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.**

**Argumentimi:**Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

*Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në përputhje me ligjin nr. 10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, Kreu V, neni 41, pika c "c) (Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen rastet kur personat juridikë kanë detyrimin që të kryejnë*

*auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese).*

**2.2.3** Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore, sipas përcaktimeve të Vendimit të Këshillit të Bashkisë përkatëse, pranë njërive të qeverisjes vendore ku operatori ekonomik ushtron ose ka ushtruar aktivitetet për vitin 2024 sipas Ekstraktit të Rregjistrimit Tregtar.

***Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DST. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten referuar përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.***

\* Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, cdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Bashkia.

**Argumentimi:** *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Per proceduratatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2 d).*

*Referuar sa mësipër, njësia e prokurimit gjykon se kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të vërtetimit të shlyerjes së detyrimeve vendore është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për tju nënshtuar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.*

## **2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

**2.3.1** Për të provuar përvojën e mëparshme operatorit ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizime të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit, nga shpallja e njoftimit të kontratës, ku vlera e kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 20% i fondit limit të kesaj kontrate

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjisllacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjisllacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:** *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që*

kanëpërvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

**2.3.2** Operatori ekonomik duhet të deklarojë në formularin e vetdeklarimit se ka 1 (një) makine transportuese, furgon me kapacitet mbajtes sipas lejes së qarkullimit nga 1.5 deri 5 ton,

***“Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatit të ankimimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar I pari, që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si më poshtë :***

për mjetet në pronësi të vertetuar me :

- leje qarkullimi
- certifikatë pronësie
- certifikatë e kontrollit teknik të mjetit ( të vlefshme )
- policen e sigurimit të mjeteve (të vlefshme)
- leje transporti nga Bashkia. (të vlefshme)
- foto të mjetit

ose

për mjetet me qira , të shoqerohet me:

- kontrate qiraje
- leje qarkullimi
- certifikatë pronësie
- certifikatë e kontrollit teknik të mjetit ( të vlefshme )
- policen e sigurimit të mjeteve (të vlefshme)
- leje transporti nga Bashkia (të vlefshme)
- foto të mjetit

*Ne rastin e mjeteve të marra me qera nga operatorët ekonomikë bazuar në njoftimin e APP nr. 4916/2 prot date 14.07.2022 , referuar dokumentacionit (leje qarkullimi, certifikate e transportit të mallrave ) , mjetet nuk duhet të rezultojnë për përdorim vetjak por për përdorim nga të tretet. ( Shenim për kapacitetin mbajtes së mjeteve të kërkuara për realizimin e punimeve. Kapaciteti mbajtes i mjeteve sipas lejes së qarkullimit do llogaritet nga diferenca midis Mases maksimale me ngarkesë të plote të lejuar në Shqipëri dhe Mases së mjetit bosh.)*

**Argumentim:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKMnr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

**2.3.3** Operatori ekonomik duhet të deklarojë në formularin e vetdeklarimit se ka një punësim mesatar i të paktën 3 (tre) punonjësish, për muajin e fundit.

***“Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatit të ankimimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar I pari, që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si më poshtë :***

- a. **Vërtetim** të lëshuar dhe konfirmuar (*me firme dhe vule*) nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve, për muajin e fundit.  
**Dhe**
- b. **Listpagesat** e konfirmuar (*me firme dhe vule*) nga Administrata Tatimore të punonjesve sipas formatit që kërkohej nga legjislacioni në fuqi për muajin e fundit.

**2.3.4** Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë në formularin e vetdeklarimit se ka të punësuar, minimalisht 3 punonjës të kualifikuar si më poshtë:

**- 1 punonjës shofer kamioni .**

***“Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimimit autoriteti kontraktor I kërkon ofertuesit I kualifikuar I pari ,dorzimin e dokumentave provuese si dhe dokumentat e tjera shoqeruese të ofertes të dorëzuar në mënyrë elektronike si më poshtë:***

1. kontrata e punës (e vlefshme);
2. leje drejtimi kategoria C
3. *Certifikate Aftësie Profesionale të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor*

**- 2 punonjes të thjeshtë**

***“Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimimit autoriteti kontraktor I kërkon ofertuesit I kualifikuar I pari ,dorzimin e dokumentave provuese si dhe dokumentat e tjera shoqeruese të ofertes të dorëzuar në mënyrë elektronike si më poshtë:***

1. kontrata e punës (e vlefshme);

***Argumentim:*** për pikat 2.3.3 dhe 2.3.4 bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohej që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Jane kërkuar minimalisht 3 persona pasi është i nevojshëm 1 shofer për transportin e peletit dhe 2 persona të tjerë për ngarkimin dhe shkarkimin në destinacionin e kërkuar.

**2.3.5** Operatori ekonomik duhet te deklaroje ne formularin e vetdeklarimit se ne rastin kur nuk eshte prodhues do te paraqese akt - mareveshje me prodhuesin/distriutorin e shitjes, te firmosur perpara noterit, per furnizimin me pelet, ku te specifikohet se ne rast te shpalljes fitues ne proceduren e prokurimit operatori ekonomik do te furnizohet me material pelet gjate periudhes te realizimit te kontrates.

Operatori ekonomik do te paraqese ne formularin e vetdeklarimit se prodhuesi i materialit pelet eshte konform sistemeve te menaxhimit te cilesise dhe ne rast se operatori ekonomik shpallet fitues do te paraqese çertifikaten ISO 9001: 2015 (Per sistemin e menaxhimit te cilesise)

*Ky kriter është vendosur për të garantuar cilësinë e matërialeve që do të përdoren dhe përputhshmërinë me specifikimet teknike.*